



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

RREGULLORE PËR SOLIDARITET DHE NDIHMË RECIPROKE PËR ANËTARËT E OSK-së

Prishtinë, Nëntor 2024

KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (OSK-së) në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Ligjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 20, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, si dhe Nenin 18, paragrafi 5 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OSK-së, e miratuar në mbledhjen e datës 16 maj 2019, e plotësuar dhe ndryshuar në mbledhjen e mbajtur me datë 25.11.2024, miraton këtë:

RREGULLORE PËR

SOLIDARITET DHE NDIHMË RECIPROKE PËR ANËTARËT E OSK-së

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit të Kuvendit të OSK-së, të dt.25.11.2024)

KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e mbështetjes financiare për anëtarët e OSK-së (në vazhdim Oda), që kanë të drejtë në ndihmë financiare.
Po ashtu me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat për dhënien e mbështetjes/ndihmës financiare për anëtarët e Odës.

Neni 2

Për dhënien e ndihmës sipas nenit 1 të kësaj rregulloreje, Oda në pajtim me ligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë dhe statutin e saj ndanë mjetet në fond të posaçëm.

Neni 3 Mjetet e Fondit

Mjetet e Fondit sigurohen nga:

1. Mjetet financiare sipas ndarjes buxhetore.
2. Kontributet vullnetare të anëtarëve të Odës dhe personave të tjerë juridik e fizik.
3. Gjobat e mbledhura nga masat disiplinore dhe taksat shtesë (dënime për mos pëmbajtje të afateve të rilicencimit dhe të anëtarësimit) të shqiptuara.

Neni 4

Mbikëqyrja e mjeteve të Fondit bëhet nga Këshilli Drejtues dhe Këshilli Mbikëqyrës.

KAPITULLI II – KOMISIONI PËR SOLIDARITET DHE NDIHMË RECIPROKE

Neni 5

Përbërja dhe funksionimi i komisionit për solidaritet dhe ndihmë reciproke

1. Komisioni për solidaritet dhe ndihmë reciproke (në vazhdim Komisioni) është organ i Odës, i cili përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve të cilët zgjedhen nga Kuvendi i Odës nga radhët e anëtarëve të Odës.
2. Puna dhe procedurat e vendimmarrjes së komisionit janë të rregulluara me Rregulloren për Procedurat e Vendimmarrjes të Organeve të Odës.
3. Mënyra e zgjedhjes, kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve të komisionit rregullohet me akt të veçantë normativ përkitazi me zgjedhjet e brendshme të Odës.

Neni 6

Kompetencat dhe përgjegjësitë e komisionit

1. Komisioni për solidaritet dhe ndihmë reciproke është komision i përhershëm i Odës, i cili ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 1.1 Të pranojë dhe shqyrtojë aplikimet e anëtarëve të Odës që kërkojnë ndihmë financiare. Ky proces përfshin mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm, siç janë raportet mjekësore, deklaratat financiare dhe të tjera dokumente që justifikojnë nevojën për ndihmë.
 - 1.2 Të vlerësoj rastet e anëtarëve të Odës që kanë nevojë për ndihmë financiare ose mbështetje tjetër për shkak të problemeve shëndetësore, fatkeqësive natyrore, apo ndonjë situatë tjetër emergjente.
 - 1.3 Të vendosë për dhënien e ndihmës financiare për anëtarët e Odës, në përputhje me rregullat dhe politikat e përcaktuara me këtë rregullore
 - 1.4 Ka obligim të informojë anëtarët për mundësitë e ndihmës dhe procedurat që duhet ndjekur për të kërkuar mbështetje.
 - 1.5 Të përgatis dhe dorëzoj raportet periodike mbi aktivitetet e tij tek organet drejtuese të Odës, duke përfshirë informacion mbi përdorimin e fondeve dhe rastet e ndihmuara.
 - 1.6 Në raste të emergjencave të papritura, si fatkeqësi natyrore apo aksidente, komisioni mund të veprojë shpejt për të ofruar ndihmë të menjëhershme për anëtarët e prekur.

- 1.7 Bashkëpunon me organet e tjera të Odës për të siguruar që ndihma të ofrohet në mënyrë të harmonizuar dhe që përpjekjet e ndryshme brenda Odës të koordinohen në mënyrë efektive.
- 1.8 Kryen detyrat tjera sipas akteve normative të miratuara nga organi kompetent i Odës.

KAPITULLI III – KRITERET, PROCEDURAT DHE MBËSHTETJA/ DHËNIA E NDIHMËS FINANCIARE

Neni 7

1. Kriteret për ndarjen e mjeteve nga Fondi i Solidaritetit janë:
 - 1.1 Sëmundjet e anëtarëve të Odës dhe anëtarit të familjes së ngushtë të tyre (bashkëshorti/ja dhe fëmijët);
 - 1.2 Humbjes së aftësisë (invaliditetit) të përcaktuar me vendim të organit kompetent, në përqindje më të madhe se 80%, për shkak të të cilës anëtari nuk mund ta kryejë në mënyrë të përhershme veprimtarinë mjekësore;
 - 1.3 Fatkeqësitë e natyrave të ndryshme, arsyeshëmria e të cilave vlerësohet nga komisioni dhe miratohet nga Këshilli Drejtues.

Neni 8

Shuma për mbështetje financiare nga Neni 7 i kësaj rregulloreje e propozon Komisioni për mbështetje/ndihmë financiare, vendos Këshilli Drejtues, në varësi të shumës së mjeteve në Fond.

Neni 9

Anëtari i Odës nuk mund të përfitojë më shumë se një herë në vit ndihmë financiare.

Neni 10

Në raste të fatkeqësive të ndryshme natyrore, emergjencave dhe gjendjet e jashtëzakonshme (vërshimet, djegiet, aksidentet e ndryshme, etj) komisioni do të vlerësoj secilin rast veç e veç dhe në pajtim me mundësitë materiale të Fondit të Solidaritetit do të merr vendim/propozon për lartësinë e dëmshpërblimit.

Neni 11

Me daljen në pension të anëtarit të Odës, i ndahet shuma prej 200 euro.

Neni 12

Në rast të vdekjes së një anëtarit të Odës, me marrjen e informatës Oda mund të mbështes financiarisht familjen e tij të ngushtë për ceremonin e varrimit me një shumë prej 200 euro.

Neni 13

1. Procedurat për dhënien e mbështetjes/ndihmës financiare janë si në vijim:
 - 1.1 Anëtari i Odës, respektivisht i autorizuari për të drejtën për ndihmë i paraqet komisionit kërkesën me shkrim për dhënien e mbështetjes/ndihmës financiare;
 - 1.2 Kërkesës i bashkëngjitet dokumentacioni përkatës me të cilin vërtetohet baza për të kërkuar ndihmë (kopje të dokumenteve mjekësore, profatura, fatura si dhe dëshmi tjera relevante);
 - 1.3 Kërkesa për dhënien e ndihmës financiare dorëzohet në afat jo më larg se 60 ditë pas plotësimit të kushteve të përmendura në dispozitat e lartpërmendura të Rregullores;
 - 1.4 Kërkesat emergjente duhet të vendosen nga komisioni në afat prej 7 ditësh nga dita e parashtrimt të kërkesës ndërsa kërkesat e tjera në pajtim me rregullat e procedurës administrative;
 - 1.5 Ndihma financiare paguhet në mënyrë të njëhershme;
 - 1.6 Në rast se kërkesa është jo e plotë, komisioni do të kërkojë nga parashtruesi që të plotësojë të njëjtën brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit;
 - 1.7 Nëse parashtruesi nuk e dorëzon dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar, komisioni do ta refuzojë kërkesën me vendim.

Neni 14

Nxjerrja e vendimit dhe e drejta e ankesës

1. Komisioni nxjerr vendim për kërkesën e paraqitur nga parashtruesi, anëtari i Odës, respektivisht i autorizuari.
2. Kundër vendimit të komisionit, parashtruesi mund të paraqet ankesë në Këshillin Drejtues.
3. Ankesa parashtrohet brenda 15 ditëve pas pranimt të vendimit të komisionit.
4. Këshilli Drejtues është i detyruar të kthejë përgjigje jo më vonë se 30 ditë nga data e pranimt të ankesës.
5. Vendimi i Këshillit Drejtues është i formës së prerë, dhe nuk mund të atakohet tutje me procedurën administrative..

Neni 15

1. Zyrtari administrativ që asiston komisionin është i detyruar të mbajë një regjistër të të gjitha kërkesave të pranuar për mbështetje/ndihmë financiare.
2. Shërbimi financiar i Odës mban regjistrin për mjetet e ndara.

Neni 16

Komisioni është i detyruar të dorëzojë një raport mbi punën e tij në Këshillin Drejtues dhe Këshillin Mbikqyrës, dy (2) herë në vit apo çdo gjashtë (6) muaj.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 17

Kërkesat e parashtruara të cilat janë në procedurë shqyrtimi para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të shqyrtohen sipas rregullores paraprake.

Neni 18

Çështjet tjera të cilat nuk janë të parapara në rregullore përcaktohen me propozim të komisionit të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Neni 19

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OSK-së dhe nënshkrimit nga ana e kryetarit të OSK-së, ndërsa zbatimi i saj fillon prej 01.01.2025.

Prishtinë, 25.11.2024



Kryetari i OSK-së

Prof. Dr. Blerim Kamberi



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosovo

KUVENDI I ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, me nënparagrafin 1.1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150, nenit 20, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 të Statutit të Odës së Stomatologëve të Kosovës, si dhe nenin 18, paragrafi 5 të Rregullores për Procedurat Vendimarrëse të Organeve të OSK-së, në mbledhjen e mbajtur më 09.12.2025, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Për plotësim ndryshimi e Rregullores për solidaritet dhe ndihmë reciproke për anëtarët e OSK-së nr. 3946 të datës 25.11.2024, ashtu që neni 11 riformulohet si në vijim:
“Me rastin e daljes në pension të një anëtari të Odës, ai përfiton një shumë prej 200.
Megjithatë kjo e drejtë nuk u takon anëtarëve që nuk i kanë permbushur obligimet e tyre financiare ndaj OSK-së”.
- II. Pjesa tjetër e rregullores mbetet e pandryshuar.
- III. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Prishtinë, 09.12.2025



Kryetari i OSK-së

Prof.Dr.Blerim Kamberi